

Në bazë të nenit 29 të Ligjit për pasurinë shtetërore ("Fl. zyr. MZ", nr. 21/09 dhe 40/10) në lidhje me nenin 194, 201, 208 dhe 2016 të Ligjit për marrëdhëniet pronësore juridike ("Fl. zyr. MZ", nr. 19/09) nenit 33, paragrafi 1, pika 1 dhe nenit 45, paragrafi 1, pika 9 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Fl. zyr. MZ" nr. 88/09, 03/10, 73/10,38/12, 10/14, 57/14 i 3/16) dhe nenit 27, paragrafi 1, pika 1, nenit 36 dhe nenit 42, paragrafi 1, pika 9 të Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. 5/07, 9/09 dhe 16/11), Kuvendi i Komunës së Ulqinit në mbledhjen e mbajtur, më 11. 07. 2018 ka nxjerrë

VENDIM

për dhënien e pëlqimit për konfirmimin e të drejtave të karakterit zyrtar me qëllim të vendosjes së linjes kablore prej 1 kv të tensionit të ulët prej TS 10/0,4 kv "Radi centar 1" deri tek dollapi vetëqëndrues Port Milena në Komunën e Ulqinit

Neni 1

Jepet pëlqimi për konfirmimin e karakterit zyrtar me kompensim në një pjesë të parc. kad. nr. 388/2 KK Ulqin, me sipërfaqe prej 29 m², me kulturë fushë F.P. nr. 184 KK Fusha e Ulqinit pronësi e Malit të Zi, dispozicion të Komunës së Ulqinit.

Neni 2

Karakterit zyrtar nga neni 1 i këtij Vendimi vendoset me qëllim të vendosjes së linjës kablore të tensionit të ulët prej TS 10/0,4 kv "Radio centar 1" deri tek dollapi vetëqëndrues Port Milena në Komunën e Ulqinit.

Neni 3

Në patundshmërinë nga neni 1 i këtij Vendimi vendoset e drejta me karakter zyrtar me kompensim në shumën prej 140 eur x 15 % të vlerës së tregut për 1 m², që në total është **609,00** euro.

Kompensimi në shumën e përmendur është caktuar nga ana e organit të autorizuar të administratës shtetërore, Drejtorisë për patundshmëri të Malit të Zi, njësia rajonale Ulqin – Komisioni për vlerësimin e vlerës së patundshmërisve për territorin e Komunës së Ulqinit nr. 02-139 të datës 17. 01. 2018.

Neni 4

Obligohet CEDIS (Sistemi elektrodistributiv i Malit të Zi), SHPK Podgoricë, rr. Ivan Milutinoviç, nr. 12, PIB 03099873, që pas përfundimit të punimeve në vendosjen e linjave kablore për të cilat konfirmohet karakteri zyrtar, toka të kthehet në gjendjen e mëparshme.

Neni 5

Autorizohet Kryetari i Komunës së Ulqinit që me shfrytëzuesin të lidhë kontratë për konfirmimin e të drejtave me karakter zyrtar në tokën nga neni 1 i këtij Vendimi.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi ditën që të botohet në "Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës".

Broj:02-130/18-3

Ulqin, 11.07.2018 viti

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT
KRYETARI
Dr. Ilir Çapuni, d.r.